


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Mars 2019

**Tiranë, më 17 Prill 2019:** Në Mars 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 28 mld lekë, duke u rritur me 2,7 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 23,0 %, në krahasim me Shkurt 2019. Importet e mallrave arritën vlerën 56 mld lekë, duke u rritur me 1,1 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 12,1 %, në krahasim me Shkurt 2019. Deficiti tregtar i këtij muaji është 28 mld lekë, duke u ulur me 0,5 %, krahasuar me Mars 2018 dhe rritur me 3,1 %, në krahasim me Shkurt 2019.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në tremujorin e parë të vitit 2019, krahasuar me një vit më parë, eksportet e mallrave arritën vlerën 72 mld lekë, duke u ulur me 3,0 %, ndërsa importet e mallrave arritën vlerën 148 mld lekë, duke u rritur me 1,2 %. Deficiti tregtar arriti vlerën 76 mld lekë, duke u rritur me 5,6 %, krahasuar me 2018.

### Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve

Rritja vjetore e eksporteve prej 2,7 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +3,8 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +1,7 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +1,1 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupi “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,6 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Mars 2019




Eksportet, gjatë këtij tremujori janë ulur me -3,0 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,6 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,6 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,7 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +1,7 pikë përqindje.

### Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve

Rritje vjetore e importeve prej 1,1%, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +3,4 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +1,4 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +1,0 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -3,6 pikë përqindje, etj.

**Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Mars 2019**



Si tremujor, importet janë rritur me 1,2 %, krahasuar me tremujorin e parë 2018. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,6 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +0,3 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +0,2 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -1,4 pikë përqindje.

**Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**


Në muajin Mars 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Mars 2018 janë: Italia (7,3 %), Kosova (86,8 %) dhe Maqedonia (45,6 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Gjermania (-13,5 %), Spanja (-54,4 %) dhe Greqia (-14,8 %).

Gjatë këtij tremujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (0,4 %), Kosova (43,7 %) dhe Maqedonia (20,1 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Gjermania (-6,7 %), Greqia (-13,4 %) dhe Kina (-43,6 %).

Në muajin Mars 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Mars 2018 janë: Greqia (18,0 %), Kina (17,0 %) dhe SHBA (19,4 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-1,6 %), Turqia (-7,4 %) dhe Gjermania (-44,4 %).

Gjatë këtij tremujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kina (16,6 %), Greqia (5,4 %) dhe Turqia (0,8 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-6,5 %), Gjermania (-23,6 %) dhe Spanja (-23,7 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Mars 2019



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 67,0 %, të gjithë tregtisë. Në Mars 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 74,7 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 63,1 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (35,0 %), Greqia (7,3 %), Kina (6,7 %) dhe Gjermania (5,8 %).

Shkëmbimet tregtare, për tremujorin e parë 2019, me vendet e BE zënë 66,5 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Mars 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 79,2 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 60,4 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (34,7 %), Greqia (7,0 %), Kina (6,7 %) dhe Gjermania (6,1 %).

**Tab. 1 Qarkullimi i mallrave**

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2017	01 - 17	19	15,6	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	Janar - Mars 17	63	17,5	133	7,7	-70	47,1
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03 - 18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	Janar - Mars 18	75	18,9	146	9,7	-72	51,0
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,1	-28	49,8
	Janar - Mars 19	72	-3,0	148	1,2	-76	48,9

**Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)**

	Eksporte				Importe			
	Mars 2018	Mars 2019	Jan.- Mar. 2018	Jan.- Mar. 2019	Mars 2018	Mars 2019	Jan.- Mar. 2018	Jan.- Mar. 2019
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>21.665</b>	<b>20.774</b>	<b>59.786</b>	<b>57.236</b>	<b>36.064</b>	<b>35.271</b>	<b>91.176</b>	<b>89.200</b>
Austri	163	163	495	676	482	891	1.393	1.746
Mbretëri e Bashkuar	77	59	158	164	373	463	1.194	1.217
Gjermani	1.282	1.108	3.614	3.372	6.723	3.735	13.099	10.005
Greqi	1.219	1.038	3.360	2.911	4.261	5.030	11.860	12.501
Itali	12.926	13.871	37.742	37.898	15.702	15.451	41.117	38.464
Spanjë	2.284	1.042	6.393	4.223	897	927	2.687	2.049
Kroaci	65	111	183	256	334	554	1.274	1.407
Të tjera të BE-së	3.648	3.381	7.840	7.738	7.291	8.221	18.552	21.810
Kinë	781	613	2.401	1.354	4.243	4.964	11.488	13.390
Kosovë	1.489	2.781	4.059	5.833	732	644	1.613	1.452
Maqedonia	595	866	1.513	1.817	734	777	1.768	1.909
Rusi	0	37	6	58	822	842	2.484	2.775
SHBA	457	514	1.309	1.166	923	1.101	2.280	2.694
Turqi	144	127	354	636	4.436	4.109	11.780	11.869
Ukrainë	37	41	62	77	146	125	541	601
Zvicër	98	172	765	258	625	803	3.140	4.474
Të tjera	1.489	1.878	3.932	3.830	6.550	7.232	19.778	19.425
<b>Gjithsej</b>	<b>27.081</b>	<b>27.804</b>	<b>74.512</b>	<b>72.263</b>	<b>55.275</b>	<b>55.867</b>	<b>146.048</b>	<b>147.791</b>

**Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)**

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Mars 2018	Mars 2019	Jan.- Mar. 2018	Jan.- Mar. 2019	Mars 2018	Mars 2019	Jan.- Mar. 2018	Jan.- Mar. 2019
<b>Gjithsej</b>	<b>27.081</b>	<b>27.804</b>	<b>74.512</b>	<b>72.263</b>	<b>55.275</b>	<b>55.867</b>	<b>146.048</b>	<b>147.791</b>
Ushqime. pije. duhan	2.413	2.863	6.004	7.093	9.488	9.431	24.545	24.729
Minerale. lëndë djegëse. en.el.	5.644	4.409	13.629	10.914	4.184	6.080	15.698	19.561
Produkte kimike dhe plastike	380	608	1.178	1.598	7.372	7.904	19.495	19.940
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	265	180	730	616	1.722	1.570	4.343	4.081
Prodhime druri dhe letre	713	833	2.147	2.334	1.983	2.067	5.165	5.430
Tekstile dhe këpuçë	10.921	10.774	31.534	30.979	7.773	7.545	20.727	20.262
Materiale ndërtimi dhe metale	4.559	4.852	13.220	11.306	6.170	6.967	17.027	17.257
Makineri. pajisje dhe pj. këmb.	1.482	2.521	4.070	5.341	14.176	12.200	33.379	31.330
Të tjera	704	763	2.001	2.082	2.406	2.102	5.668	5.201

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)**

	Itali		Kosovë		Spanjë		Gjermani	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
<b>Gjithsej</b>	<b>37.742</b>	<b>37.898</b>	<b>4.059</b>	<b>5.833</b>	<b>6.393</b>	<b>4.223</b>	<b>3.614</b>	<b>3.372</b>
Ushqim. pije duhan	1.902	2.131	430	610	252	369	294	326
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	561	1.777	336	1.596	5.256	3.216	591	377
Produkte kimike dhe plastike	348	479	208	371	11	10	7	18
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	588	511	1	1	61	35	3	4
Prodhime druri dhe letre	1.525	1.691	101	184	1	1	39	30
Tekstile dhe këpucë	24.333	24.271	23	19	740	498	2.042	1.716
Materiale ndërtimi dhe metale	4.904	3.622	2.571	2.558	63	91	213	361
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	2.523	2.435	145	144	2	2	291	379
Të tjera	1.058	982	244	349	6	1	133	161

**Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)**

	Itali		Kinë		Greqi		Turqi	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
<b>Gjithsej</b>	<b>41.117</b>	<b>38.464</b>	<b>11.488</b>	<b>13.390</b>	<b>11.860</b>	<b>12.501</b>	<b>11.780</b>	<b>11.869</b>
Ushqim. pije duhan	4.396	4.469	127	231	3.630	3.485	1.298	1.330
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	2.758	1.803	1	1	1.913	2.826	112	168
Produkte kimike dhe plastike	3.996	4.238	1.177	1.236	1.656	1.813	1.823	1.637
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	3.385	3.308	185	213	27	9	70	67
Prodhime druri dhe letre	1.685	1.546	244	188	691	689	617	670
Tekstile dhe këpucë	10.379	9.828	2.448	2.459	963	921	3.691	3.966
Materiale ndërtimi dhe metale	5.102	4.818	1.483	1.904	1.994	1.810	1.977	2.266
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	7.968	7.256	4.730	5.976	647	575	1.584	1.391
Të tjera	1.448	1.199	1.093	1.183	336	373	608	375

# Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë. të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues. pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri